

**VENDIM**  
**Nr. 291, datë 11.5.2022**

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 201, DATË 25.3.2021, TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR  
FINANCIMIN E RIFORCIMIT TË NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA  
(PALLAT) NË BASHKITË DURRËS DHE KAMZË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në vendimin nr. 201, datë 25.3.2021, të Këshillit të Ministrave, pas pikës 2 shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

“2/1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022, në masën 278 585 905 (dyqind e shtatëdhjetë e tetë milionë e pesëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e pesë) lekë pa TVSH, për financimin e riforcimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të cilat janë klasifikuar si objekte të pabanueshme ose të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para, por kanë nevojë për punime rikonstruksioni ose riparime, i cili do të përballohet nga hapësira buxhetore e siguruar pas ngurtësimit në të njëjtën masë të fondeve të projekteve të rindërtimit me ecuri të ngadaltë dhe u transferohet bashkive Durrës dhe Kamzë në formën e transfertës së pakushtëzuar, sipas detajimit të mëposhtëm:

- a) Bashkisë Durrës i transferohet fondi, në masën 100 000 000 (njëqind milionë) lekë pa TVSH;
- b) Bashkisë Kamzë i transferohet fondi, në masën 178 585 905 (njëqind e shtatëdhjetë e tetë milionë e pesëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e pesë) lekë pa TVSH.

2. Ngarkohen zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe bashkitë Durrës dhe Kamzë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**